Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

**Referuar Neni 83 te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

Shtojca 7/1 Sigurimin e ofertës referuar Neni 83 te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (sipas nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 33.323 (Tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e tre) **Lekë**

Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Në rastet e grupeve ekonomike të operatorëve ofertues referuar Neni 14 pika 2 te Ligjit 162/2020 ku citohet:

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin

e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

Pas shpalljes së fituesit dhe formalizimit të formës ligjore të tyre duhet të dorëzohen:

- Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- h. Sigurimin e ofertës referuar Neni 83 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" sipas shtojcës 7/1
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Të paraqesi një ekstrakt të QKB ku të jetë specifikuar qartësisht objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik, i njëjtë me objektin e prokurimit.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve. Vlera e xhiros mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më e vogël se vlera e fondit limit.
- Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit të vitit 2018, 2019 dhe 2020, të paraqitura në autoritetet përkatëse.

- Vertetim të rifreskuar (30 ditëve të fundit nga momenti i dorëzimit të ofertave) të lëshuar nga Bashkia ose njesite administrative që nuk ka detyrime pranë të gjitha njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit në QKB.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se)

2.3 Për kapacitetin teknik:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % **të fondit limit** që prokurohet.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të nënshkruara nga të dyja palët ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001: 2015** të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin mostrat e produkteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda datës 24/05/2021 ora 11:00, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse. Kriteri i shërbimit Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesën për prokurim.
 - **Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike.**
 - **Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikime Teknike:

Specifikimi i materialeve, skicimet, parametrat teknik etj. janë si mëposhtë:

1. Kapëse aktesh me veshë të mëdha (binder clips)

- Kapëse dokumentash me përmasa 51 mm;
- Paketimi: 12 kapëse/kuti;
- Materiali: Çelik

2. Kapëse aktesh me veshë të mesme (binder clips)

- Kapëse dokumentash me përmasa 25 mm;
- Paketimi: 12 kapëse/kuti;
- Materiali: Çelik

3. Kapëse aktesh me veshë të vogla (binder clips)

- Kapëse dokumentash me përmasa 15 mm;
- Paketimi: 12 kapëse/kuti;
- Materiali: Çelik

4. Bllok shënimesh

- Me përmasa 21x15 mm;
- Me vija, i përshtatshëm për shënime ditore;
- Të jetë kalendarik me datë dhe ditë për vitin 2021 në secilën nga faqet.
- Me kapak lëkurë fabrike

5. Bojë vule protokolli

- Boje për vulë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave të gomës. Bojë ekologjikisht e pastër dhe shumë rezistente.
- Paketim: 30ml

6. Bojë vule stamp/protokolli kompatibël për vulë “Brother”

- Ngjyra: Blu;
- Të jetë kompatibël për vulë stamp të markës “Brother”
- Të jetë bojë që thahet shpejt në mënyrë që të parandaloj njollat dhe ndotjen e letrës
- Përbërja: Lëng me bazë vajin
- Paketimi: 20 (mililitër)
- Të jetë shumë cilësore

7. Kapak transparent për lidhje A4

- Material plastik i tejdukshëm, me përmasa fletë format A4;

8. Kapak kartoni A4 me ngjyrë

- Material kartoni me ngjyra të ndryshme, me përmasa fletë format A4;

9. Dosje me buton

- Me kapak të përbërë prej kartoni të trashë;
- Me përmasa (gjatësi x gjerësi x lartësi): 35 x 25 x 15 cm;

10. Dosje me lidhëse

- Me përmasa (gjatësi x gjerësi x lartësi): 33 x 23 x 10 cm;
- Material: karton i trashë;
- E përshtatshme për arshivim dokumentash të cilat ruhen për një afat kohor jo më pak se 5 vjet;
- Me kapak (karton) mbulues nga të treja anët e dosjes

11. Dosje me llastik

- Me përmasa (gjatësi x gjerësi x lartësi): 34,5 x 25 x 2 cm;
- Material: karton i trashë me lidhëse llastik horizontalisht;

12. Dosje me mekanizëm

- Me kapak të përbërë prej materiali plastik;
- Me përmasa (gjatësi x thellësi x lartësi) mm: 280 x 80 x 320 mm;
- Të jetë në gjendje të mbaj minimalisht 375 fletë formati A4 (80gsm);
- Me xhep plastik të tejdukshëm nga jashtë

13. Dosje personale me 50 zarfa

- Të ketë në brendësi të saj të ngjitura në trup jo më pak se 50 qese A4 për arkivim dokumentacioni;
- Të jetë me veshje të jashtme plastike;

14. Dosje të thjeshta kartoni

- Të përshtatshme për arkivim dokumentacioni;
- Materiali: karton i trashë me ngjyrë të bardhë;
- Përmasat: 34x25 cm

15. Evidenciator (evidencier)

- Shënues (*Highlighter*) me përmasa evidentimi të shënimit nga 1,0 deri në 5,0 mm;
- Të jetë i përdorshëm për tekste të printuara me bojë, printime lazer dhe tekste me shkrim dore.
- Të jenë me ngjyra të ndryshme të cilat lejojnë leximin e tekstit të shënuar (evidentuar)

16. Gërshërë

- Të përshtatshme për prerje material: letre, plastike e hollë, pëlhure dhe karton i hollë;
- Me përmasa: gjatësi totale midis 175 dhe 185 mm;
- Me doreza me veshje plastike dhe teh prerës prej materiali çelik i pandryshkshëm;
- Peshë totale midis 0,06 dhe 0,1 kg;
- Teh i mprehtë dhe shumë cilësor

17. Kapëse aktesh normale (paper clips)

- Me përmasa: 33 mm dhe paketim 100 copë kuti

18. Kapëse aktesh të gjata (paper clips)

- Me përmasa: 50 mm dhe paketim 100 copë kuti

19. Makina kapëse aktesh në formë gërshëre

- E përshtatshme për kapëse metalike 24/6;
- Minimumi i fletëve format A4 (80 gsm) që mund të kapi njëkohësisht të jetë jo më pak se 20 copë;
- Të jetë metalike dhe shumë cilësore

20. Korrektor stilo metal

- Të përmbajë minimalisht 7ml lëng;
- Të jetë në formë stilolapsi;
- Të jetë lëng cilësor, i lëmuar dhe që thahet shpejt;

21. Lapsa me gomë

- I lehtë për tu fshirë dhe për tu mprehur;
- Shkalla e plumbit: HB nr.2;
- Të jetë me gomë në njërin krah të tij

22. Mprehëse lapsash

- Përbërja: Materiali metalik dhe plastik

23. Makinë llogaritëse

- Me ekran të përthyer për një pamje më komode;
- Furnizimi me energji: një bateri AA 1,5V dhe me rreze diellore;
- Me përmasa (mm): gjerësi 130 deri në 160 mm dhe gjatësi 180 deri në 210 mm;
- Ekran i madh me 12 karaktere;
- Të jetë e përshtatshme për ambiente zyre me funksionet bazike financiare

24. Shënues për CD/dosje

- Shënues me bojë të zezë cilësore që thahet shpejt dhe nuk fshihet;
- Me majë të rrumbullakët me përmasa 2 mm;

25. Mbajtëse dokumentash

- Mbajtëse dokumentash me 3 (tre) raftet secila;
- Raftet të jenë me material alumini dhe rrjetë teli;
- Krahët e mbajtëses të jenë të lidhura ndërmjet tyre me mekanizëm;

26. Mbajtëse kancelarie

- Të jetë prej materiali metaik në formë cilindri me diametër 8,5 cm

27. Natërban (adeziv)

- I përshtatshëm për paketim material si: letër, plastik, qelq, hekur etj.;
- Me gjerësi 50 mm dhe gjatësi totale (të një rrote) jo më pak se 50 metër;
- E përbërë nga material plastik (plasma) i tejdukshëm.

28. Postite 76x76 (100 sheets)

- Me ngjyra të ndryshme me përmasa flete 76x76 mm, me ngjitje në njërin krah;
- Me përbërje material letër cilësor 75 gsm;
- Paketimi: 100 (njëqind) fletë për çdo pako;
- Të jenë shumë cilësore dhe me ngjitës të fortë;

- Secila prej fletëve të mund të shkëputet lehtësisht pa dëmtuar fletët e tjera të ngjitura me të

29. Postite shirit 15x50 (4x40 sheets)

- Me ngjyra të ndryshme me përmasa të një flete 15x50 mm, me ngjitje në njërin krah;
- Me përbërje material letër cilësore 75 gsm;

30. Heqëse teli

- Materiali: Metalik;
- Të jetë në formë pince

31. Stik ngjitës

- Pesha neto: 9 gramë
- I përshtatshëm për të vepruar mbi letër, foto, karta etj. Të mospërmbajë acid i cili është një elementë i dëmshëm për shëndetin.
- Të jetë lehtësisht i aplikueshëm gjatë përdorimit dhe me ngjitje të fortë e cilësore;
- Ngjyra: i tejdukshëm

32. Stilolapsa

- Me bojë blu cilësore që thahet shpejt dhe nuk fshihet;
- Me majë të rrumbullakët me përmasa 0,8 mm, me gjerësi vije 0,4 mm;
- Të jenë shumë cilësor dhe të shkruajnë lehtësisht pa ushtruar forcë mbi të

33. Stilolapsa me bojë

- Me bojë blu (lëng) cilësore që thahet shpejt dhe nuk fshihet edhe pas një periudhe jo më pak se 5 vjet duke qenë i përshtatshëm për arkivimin e dokumentave;
- Me majë të rrumbullakët me përmasa 0,7 mm, me gjerësi vije 0,5 mm;
- Rezistent ndaj dritës dhe ujit dhe me cilësi të lartë

34. Tampon njomës/protokolli

- Me material plastik dhe sfungjer në brendësi të tij

35. Tela për makinë kapëse 24/6

- Me përbërje metal i zinkuar ngjyrë gri dhe cilësore;
- Paketimi: 1000 (njëmijë) tela/kuti

36. Tela për makinë kapëse 23/13

- Me përbërje metal i zinkuar ngjyrë gri dhe cilësore;
- Paketimi: 1000 (njëmijë) tela/kuti

37. Zarfa qese A4

- Materiali: qese plasmasi shumë rezistente dhe cilësore, me paketim 100 qese/pako

38. Zarfa A4

- Materiali: letër me trashësi 90 gsm

39. Zarfa A5

- Materiali: letër me trashësi 80-100 gsm

40. Zarfa me dritare

- Dritarja e zarfit të jetë e pozicionuar në pjesën djathtas poshtë, në pjesën balllore
- Përmasat e zarfit të jenë 23x11,5 cm
- Përmasat e dritares së zarfit të jenë 10x5 cm
- Ngjyra e zarfit të jetë e bardhë

41. Zarfa për CD me dritare

- Dritarja e zarfit të jetë e pozicionuar në pjesën ballore të zarfit
- Ngjyra e zarfit të jetë e bardhë

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1.	Binder clip të mëdha	kuti	300
2.	Binder clip të mesme	kuti	300
3.	Binder clip të vogla	kuti	300
4.	Blllok shënimesh	copë	100
5.	Bojë vule protokolli	copë	60
6.	Bojë vule stamp / protokolli (për vulë Brother)	copë	15
7.	Kapak transparent A4	copë/fije	50
8.	Kapak kartoni A4	copë/fije	50
9.	Dosje me buton	copë	200
10.	<i>Dosje me lidhëse</i>	<i>copë</i>	<i>7.230</i>
11.	Dosje me llastik 25x34,5	copë	300
12.	Dosje me mekanizëm	copë	200
13.	Dosje personale me 50 zarfa	copë	100
14.	Dosje të thjeshta kartoni	copë	30.000
15.	Evidencier me ngjyra	copë	300
16.	Gërshërë	copë	30
17.	Kapëse aktesh normale	kuti	1.200
18.	Kapëse aktesh të gjata	kuti	500
19.	Makinë kapëse dokumentash	copë	100
20.	Korrektor	copë	100
21.	Lapsa	copë	200
22.	Mprehëse lapsash	copë	50
23.	Makinë llogaritëse	copë	110
24.	Shënues për CD/dosje	copë	80
25.	Mbajtëse dokumentash	copë	70
26.	Mbajtëse kancelarie	copë	120
27.	Natërbani i madh	copë	50
28.	Postite 76x76 100 sheets	pako	400
29.	Postite 15x50 mm 4x40 sheets	pako	200
30.	Heqëse teli	copë	100
31.	Stik ngjitës	copë	80
32.	Stilolapsa	copë	1.700

Dokumentat Standarde të Tenderit

33.	Stilolapsa me bojë	copë	100
34.	Tampon njomës/protokoll	copë	50
35.	Tela makine 24/6	kuti	1.200
36.	Tela makine 23/13	kuti	200
37.	Zarfa qese A4	pako	300
38.	Zarfa A4	copë	5000
39.	Zarfa A5	copë	3.000
40.	Zarfa të vegjël me dritare	copë	50.000
41.	Zarfa CD me dritare	copë	200

Afatet e lëvrimit:

20 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes së kontratës.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR²

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

² Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

